



BANKING AND PAYMENTS AUTHORITY OF KOSOVO
AUTORITETI BANKAR DHE I PAGESAVE TE KOSOVES
BANKARSKI I PLATNI AUTORITET KOSOVA

Letër Këshilluese 2006-3

11 Maj 2006

Standardet Minimale për Menaxhimin e Rrezikut të Kredisë

1. QËLLIMI

Kjo letër ka për qëllim që në një dokument të vetëm të paraqes udhëzimet për standardet minimale për menaxhimin e rrezikut të kredisë. Në vazhdimësinë e kryerjes së aktiviteteve të mbikëqyrjes, BPK-ja ka vërejtur se menaxhimi i rrezikut të kredisë është një çështje sistematike të cilës i nevojitet vëmendja nga ana e Bordit Drejtues të bankave. BPK-ja është në proces të rishikimit dhe plotësimit të Rregullës Bankare Nr. IX – Klasifikimet e mjeteve të bankës dhe rezervat për humbjet nga huatë, dhe gjithashtu do të nxjerr Rregullën mbi Interesin aktual/jo aktual (jo të përlogaritur) dhe atë mbi Ristrukturimin e kredive të këqija. Kjo letër i plotëson këto rregulla. BPK-ja pranon që secila bankë mund të ketë sisteme dhe politika të ndryshme për menaxhimin e rrezikut të kredisë. Përmbajtja e kësaj letre duhet të shikohet si udhëzues. I përfshinë ato aspekte apo principe thelbësore të menaxhimit të rrezikut të kredisë, të cilat Mbikëqyrja e BPK-së i konsideron si esenciale. I përfaqëson standardet, të cilat BPK-ja do t'i përdorë për të parë dhe vlerësuar se sa mire bankat e menaxhojnë ekspozimin e rrezikut të kredisë. BPK-ja pret që bankat të zhvillojnë apo riplotësojnë politikën, procedurat dhe sistemet e tyre për menaxhimin e rrezikut të kredisë në mënyrë që në thelb të jetë konform me këto standarde.

2. STANDARDET E MENAXHIMIT TË RREZIKUT TË KREDISË

Secila bankë duhet të ketë një strukturë organizimi me sisteme të menaxhimit të rrezikut, të cilat janë adekuate të identifikojnë, masin, monitorojnë dhe kontrollojnë rrezikun në të gjitha operimet bankare. Ekspozimet që bartin rreziqe kreditore përfshijnë kreditë, avanset, strukturat e mbitërheqjes, letra me vlerë, llogari depozituese me bankat e tjera, kredi bankave tjera, llogari të përkohshme, garancionet, letër kreditë, kontratat përpara si dhe transaksione të ngjashme ku borxhliu/ekspozimi i palës së kundërt ka apo mund të ketë një obligim të mundshëm apo direkt ndaj bankës.

A. STANDARDET ORGANIZATIVE DHE ADMINISTRATIVE

1. Roli dhe përgjegjësitë e Bordit të Drejtorëve

BPK-ja e konsideron Bordin Përgjegjës për organizimin dhe mbikëqyrjen e përgjithshme të funksionimit të kredive. Në mënyrë që të organizojë dhe të mbikëqyrë sa më mirë aktivitetet e huadhënies së bankës, bordi, në një shkallë minimumi, është përgjegjës me sa vijon:

- a. Të formulojë një politikë të shkruar për kreditë. Politika duhet të definoj rreziqet që janë të pranueshme dhe të pa pranueshme për bankën, gjithashtu duhet të japë udhëzime dhe standarde për të administruar saktë menaxhimin e pranueshëm dhe të vazhdueshëm të rrezikut të portofoliosë. Bordi është gjithashtu përgjegjës për rishikim e kësaj politike periodikisht dhe për ripunimin e saj si reagim ndaj ndryshimeve të faktorëve të brendshëm dhe të jashtëm.
- b. Nëpërmjet rishikimit periodik të raporteve që vijnë nga menaxhmenti, auditorët e brendshëm dhe të jashtëm dhe Drejtoriatin për Mbikëqyrje Bankare të BPK-së, duhet të garantoj pajtueshmëri me politikat e krijuara.
- c. Të krijoj një autoritet për dhënien e kredive dhe limite për zyrtarët e bankës dhe komitetet e kredive. Bordi është përgjegjës për aprovimin e kërkesave të mëdha për kreditë të cilat janë mbi autoritetin e zyrtarëve apo një menaxheri të komitetit të kredive dhe gjithashtu për ato që nuk janë në konform me politikat dhe strategjitë e bankës. Bordi, apo një komitet i dizajnuar me anëtarë të bordit, duhet që si prioritet të ofroj një rishikim/aprovimit dhe monitorim të vazhdueshëm të kredive të brendshme, veprimeve me kredi problematike, përkushtime të mëdha për huadhënie, apo ndonjë ekspozim tjetër që mund t'i sjell bankës ndonjë rrezik të posaçëm.
- d. Të aprovoj provizionet për humbje nga huatë ndaj ekspozimit të kredive dhe fshirjes së këtyre ekspozimeve.
- e. Të rishikoj raportet në aspekte të ndryshme të portofoliosë kreditore dhe aktiviteve të tjera bankare që bartin me vete rrezik kreditor në mënyrë që të vlerësojnë kushtet e kredisë/portofolionë e aseteve, praktikat e menaxhmentit për huadhënie, si dhe pajtueshmërinë me Rregulloren dhe Rregullat e BPK-së.
- f. Të kenë njohuri në lidhje me ligjet dhe Rregullat që kanë të bëjnë me huadhënien. Nëse ka probleme ligjore në lidhje me ndonjë transaksion të kredive, bordi duhet të caktoj një avokat dhe kurdo që është e nevojshme t'i diskutojnë transaksionet me Drejtoriatin e Mbikëqyrjes Bankare të BPK-së, para kompletimit të transaksionit.
- g. Të siguroj takim me oficerët e kualifikuar kreditorë dhe të siguroj trajnim adekuat dhe profesional që të ndihmojë në zhvillimin e tyre të vazhdueshëm.

2. Përgjegjësitë e Nëpunësve dhe Menaxherëve

BPK-ja pret që personeli, që është përgjegjës për të vlerësuar punët e përditshme që ndikojnë në portofolionë kreditore, të jetë i kualifikuar dhe i arsimuar. Nëpunësit kreditorë dhe Menaxhmenti i lartë kreditorë janë përgjegjës për implementimin e politikave kreditore të bankës dhe të sigurojnë pajtueshmëri me to. BPK-ja vlerëson aftësinë e këtyre individëve dhe atë për të:

- a. Që me saktësi të identifikojë, masë dhe menaxhojë rrezikun e portofoliosë.
- b. Të masë mundësitë e biznesit dhe të lejojë kredi në pajtim me politikat kreditore dhe autoritetet e tyre të huadhënjes.
- c. Komunikuar dhe ruajtur marrëdhëniet me huamarrësit.
- d. Siguruar se dokumentacioni i kredive përmban informata të duhura dhe të freskuara.
- e. Rishikuar dhe monitoruar ekspozimet/klientët për të cilët ata janë përgjegjës.
- f. Kuptuar dhe për të zbatuar Rregulloren dhe Rregullat e aplikueshme të BPK-së dhe për të implementuar politikën e brendshme të huadhënjes
- g. Mbledhur kredi kurdo që është e nevojshme.

3. Komiteti i Kredive

Aktiviteti kreditor bankar duhet të organizohet nëpërmjet një Komiteti të Kredive, i cili duhet të jetë në nivel të bordit apo menaxhmentit. BPK-ja ka vërejtur se komitetet e kredive në nivel të bordit kanë pasur tendenca të jenë vetë shërbyese apo tepër të përfshirë në vendimet e përditshme që janë përgjegjësi e menaxhmentit. Për këto arsye, çdo komitet i kredive në nivel të bordit duhet të që më parë të përcaktoj në mënyre specifike përgjegjësitë e mbikëqyrjes se sa ato operacionale. Komiteti në nivel të bordit duhet të rishikoj dhe ratifikoj veprimet e menaxhmentit dhe çdo komitet të kredive në nivel të menaxhmentit. Komiteti i Kredive në nivel të menaxhmentit duhet të përbëhet nga oficerët më të lartë kreditor. Komiteti duhet të mbledhet rregullisht. Në vijim paraqiten detyrat dhe përgjegjësitë themelore që BPK-ja i konsideron për një komitet të tillë:

- Të aprovoj apo refuzoj kërkesat për kredi brenda limiteve të përcaktuara. Komiteti zakonisht është përgjegjës për rishqyrtimin e kërkesave për kredi që tejkalojnë autoritetin e huadhënjes të shumicës së zyrtarëve të llogaritur.
- Të rishqyrtoj raportet e aktiviteteve të kredive të reja/strukturave, pagesave, përtëritjeve.
- Të rishikoj afatet e kthimit të kredive dhe strukturat e mbarimit të afatave.

- Të rishikoj përjashtimet e dokumentacionit të kredive dhe kolateralit.
- Të rishqyrtojë kreditë e vonuara dhe ekspozimet problematike.
- Të rishikoj portofolionë dhe anagazhimet jashtë bilancore si dhe obligimet e mundshme për të përcaktuar ekspozimet e kredive të mëdha.
- T'i raportoj menaxhmentit ekzekutiv apo bordit në lidhje me atë çështje që kanë nevojë për dijeninë, aprovimin dhe veprimin e tyre.

4. Sistemet Informative të Kredive

Bankat duhet të kenë një sistem të duhur informativ për kreditë në mënyrë që të monitorojnë dhe kontrollojnë rreziqet kreditore si duhet. Sistemi informativ kreditor është pjesë dhe duhet të integrohet bashkë me sistemin e gjerë informativ të menaxhmentit (MIS). Sistemi informativ kreditor duhet të siguroj informacion në lidhje me portofolionë kreditore që është e nevojshme për menaxhmentin e bankës dhe bordin për të marrë vendime të matura dhe të arsyeshme. Sistemi informativ kreditor mund të jetë në formë të një manuali, sistem i automatizuar apo edhe i kombinuar. Sistemi duhet të jetë i mjaftueshëm për përmbushjen e objektivave kyçe të biznesit bankar, dhe duhet të jetë i arritshëm dhe i përdorshëm nga i tërë personeli dhe nivelet e duhura në bankë. BPK-ja do të vlerësoj sistemin për të përcaktuar nëse menaxhmentit dhe bordit i ofron informacion të saktë dhe të duhur për të drejtuar operacionet kreditore dhe për të mundësuar vendim-marrjet në kohë, dhe gjithashtu nëse i ndihmon menaxhmentit për të monitoruar rrezikun dhe përparimin drejtë arritjes së qëllimeve bankare. Sistemi duhet të jetë i aftë për të nxjerr informata në lidhje me portofolionë kreditore i cili nevojitet për qëllime të ekzaminimit në vend 'on site'. Gjithashtu duhet të jetë i aftë të gjenerojë informata me të cilin do t'i raportonte BPK-së në baza periodike, për shembull në lidhje me kreditë që janë të lidhura të cekura me Rregullën Bankare të BPK-së Nr. XI.

BPK-ja do të vlerësoj se sa mirë sistemi informativ i kredive i arrijnë objektivat në vijim:

- Rritjen e komunikimit në lidhje me portofolionë kreditore ndërmjet stafit të huadhënjes, nëpunësve, menaxhmentit dhe bordit.
- Sigurimi i një sistemi objektiv për regjistrimin dhe grumbullimin e informatave të portofoliosë kreditore.
- Reduktimi i shpenzimeve me anë të rritjes së efikasitetit të regjistrimit dhe mbledhjes së informatave.
- Mbështetja e qëllimeve dhe direktivave strategjike të bankës.
- T'i ndihmoj menaxhimit të rrezikut duke i ofruar me kohë informata relevante të portofoliosë.

Sistemi duhet t'i mundësoj menaxhmentit dhe bordit t'i identifikoj, monitoroj, matë, dhe kontrolloj rreziqet në portofolio. Duhet t'i ndihmoj menaxhmentit të masë performancën, të menaxhojë burimet dhe të siguroj pajtueshmëri me kërkesat rregullative, si për shembull pajtueshmërinë me kufizimet ligjore të huadhënës dhe ekspozimet kreditore ndaj personave të brendshëm. Raportet në vijim të menaxhmentit, për veç bilanceve dhe hyrjeve të aktiviteteve të përditshme, konsiderohen të jenë minimale për menaxhmentin e bankës dhe drejtorët për marrjen e vendimeve, monitorim dhe planifikim:

Raporti i kredive të vonuara / dhe i kredive të pa arkëtuara që tregon informacion themelor në lidhje me të gjitha kreditë e vonuara dhe kreditë e paarkëtuara dhe mbarimin e strukturave, numri i ditëve delikuede që prej mbarimit si dhe statusin e tyre – që do të thotë mbi baza të përlogaritjes apo të kundërtën.

Raporti kronologjik/ i agreguar – që mbledh dhe i grupon të gjitha delikuedat sipas kohës.

Raport i përkohshëm i mbitërheqjes – që paraqet të gjitha ekspozimet të cilat nuk operojnë sipas marrëveshjeve formale dhe datës së lejimit.

Raporti i përgjithshëm i mbi linjave kreditore – që paraqet të gjitha të mundësitë sikurse janë linjat kreditore si dhe linjat e mbitërheqjeve nëse janë duke operuar në tejkalim të kufijve të aprovuar.

Raporti i historisë së kredisë – do të paraqiste pasqyrën e pagesave që nga fillimi apo për një periudhë të caktuar kohore historike.

Ekspozimet kreditore personave të brendshëm si dhe raporti i interesave të tyre të lidhura –që përmban informacione në lidhje me të gjitha kreditë personave të brendshëm si dhe palëve të tyre të lidhura.

Raporti i përbërjes së portofoliosë - përmban një përmbledhje informatash për të gjithë portofolionë sipas llojit, si dhe krahasimin që nga periudha e fundit e raportimit .

Raporti i shpërndarjes sipas sektorëve – që paraqet përmbledhjen e ekspozimeve kreditore në sektorë të ndryshëm ekonomik, industrial dhe / apo sektorë gjeografik.

Raporti i Ekspozimeve problematike (të klasifikuara) – që paraqet informacione në lidhje me kreditë problematike, klasifikimet e tyre, përcjellja e provizionit specifik, dhe interesat e vonuara.

Raportet e kredive të ripërtërira dhe ristrukturuara – që do t'i ndihmonte menaxhmentit apo bordit të monitorojnë progresin në kreditë e ristrukturuara.

Raportet e ekspozimeve të mëdha – përmbajnë informacione në lidhje me shumën e mbledhur të një huamarrësi apo grupi të huamarrësve të lidhur mbi nivelin mesatar të përqindjes së kapitalit apo rezervave.

Raporti i statusit të nëpunësit/filialës – që paraqet sipas nëpunësit/filialës madhësinë, llojin, statusin dhe volumin total të kredive për të cilat nëpunësi/filiala është përgjegjëse.

Raportet e angazhimeve dhe obligimeve të rastit – që ofron detaje adekuate të linjave të kredive, letrave të kredive, garancioneve, dhe zërat tjerë jashtë bilancorë.

Raporti i aktivitetit të bizneseve të reja – me informacione në lidhje me kreditë e reja.

Këto raporte nga sistemi duhet të jenë të qarta, kuptimplota, të sakta dhe në kohë.

Sistemi informativ kreditor i bankës duhet të siguroj një bilanc verifikues për të gjitha llogaritë dhe një librat e llogarive mbi aktivitetet e secilit departament që kanë përgjegjësi në lidhje me kreditë . Sistemi duhet të siguroj informacion të saktë për nëpunësin e bankës, auditorin apo ekzaminuesin e BPK-së në mënyrë që të kenë mundësi të rishikojnë historinë e një kredie në veçanti që nga fillimi e deri në kohën e tanishme. Së bashku me dokumentacionin e kredisë, informatat gjithashtu duhet të ofrojnë një pikëpamje të plotë të ekspozimeve.

5. Departamenti për shpëtimin e kredive problematike

Bankat e mëdha, si dhe bankat me kredi të mëdha problematike duhet të kenë një departament shpëtimi apo departament për kreditë problematike. Departamenti duhet të jetë përgjegjës për zgjidhjen e kredive problematike në raste kur procesi normal i mbledhjes është i pasuksesshëm. Stafi i shpëtimit duhet të zhvilloj strategji që i mundëson huamarrësit të realizoj pagesën e tij të kredisë në afatin e përcaktuar. Ata mund të ristrukturojnë afatet kreditore dhe të mundësojnë ndonjë kolateral shtesë apo mbështetje të mundshme. Ky departament duhet të veproj nëse është e nevojshme në raste të likuidimit të kolateralit apo të negociojë me kreditorët e tjerë. Departamenti i shpëtimit gjithashtu merret me ripagimin apo mbledhjen e kredive të mëparshme të shlyera .

6. Departamenti i Kredive

Bankat e mëdha duhet të kenë një departament për të mbledhur, analizuar dhe mirëmbajtur informatat e kredimarrësit, informata të cilat ruhen në dosjen e kredive për secilin kredimarrës. Departamenti i Kredive duhet të jetë përgjegjës për mirëmbajtjen e dosjeve të kredive dhe të siguroj që informatat më të reja financiare të jenë dokumentuar në dosje. Departamenti është përgjegjës për përpilimin e shqyrtimeve të kredive, analizave të kredimarrësve të rinj, ripërtëritjeve të kredive dhe zgjatjes së kredive. Departamenti i Kredive i raporton menaxhmentit të lartë të kredive dhe bordit, gjithashtu ky departament mund t'i klasifikoj kreditë duke vepruar brenda shqyrtimit të brendshëm të kredive. Në institucionet më të vogla apo institucionet me portofolio më të vogël kreditore, këto përgjegjësi mund t'i besohen

një apo më tepër individëve të cilët nuk janë pjesë e procesit të vendim marrjes së kredive.

B. POLITIKAT DHE PROCEDURAT E MENAXHIMIT TË RREZIKUT TË KREDIVE

1. Politikat e kredive

Themelimi i një politike kreditore të shkruar nga ana e bankës është bazë për një menaxhim të sigurt të portofoliosë. BPK-ja i kushton vëmendje të madhe krijimit të politikave të shkruara formale nga ana e bordit. Bordi, duke ua ndarë detyrat depozitorëve dhe aksionarëve, duhet të sigurojë që ekspozimet në portofolionë e bankës janë bërë sipas këtyre tri objektivave, si vijon:

- Të jap kredi ne baza të sigurta dhe të mbledhjes.
- T'i investojë fondet e bankës për përfitimet e aksionarëve dhe mbrojtjen e depozitorëve.
- T'u shërbejë nevojave ligjore kreditore të komunitetit në cilin banka është e vendosur.

Politika e kredisë dallon nga procedurat kreditore. Bankat duhet t'i kenë që të dy llojet e dokumentacionit që të adresojë në mënyrë adekuate të gjitha zonat e huadhënies dhe të administrimit të kredisë. Politika duhet të përmbaj një plan të përgjithshëm të shtrirjes së aktivitetit të bankës në fushën e kreditimit dhe mënyrën se si ekspozimet kreditore janë lejuar, shërbyer dhe mbledhur. Politika duhet të ketë natyrë të gjerë dhe të mos jetë e kufizuar tepër. Politika duhet t'i ofroj bordit apo komitetit, një prezantim të kredive që nëpunësit kreditor mendojnë se janë thellësisht të sigurta dhe që ia vlejné të merren në konsideratë edhe nëse mund të mos jenë në pajtim me aspekte të caktuara të politikës së shkruar të bankës. Fleksibiliteti duhet të ekzistojë që të lejojë adoptimin gjatë ndryshimit të kushteve të mjeteve fitimprurëse të bankës dhe brenda zonës së saj së shërbimit.

Në zhvillimin e politikës së kredisë duhet të merren në konsideratë burimet financiare që janë në dispozicion, personelin, mundësitë si dhe potencialin e ardhshëm të rritjes. Politika duhet të krijohet nga bordi i bankës dhe të administrohet nga menaxhmenti i lartë i kredive. Politika duhet t'i adresohet qartazi menaxhmentit të bankës dhe stafit kreditor. Të paktën një herë në vit duhet të rishikohet nga bordi dhe menaxhmenti i kredive dhe të ripërtërihet sipas nevojës për të reflektuar situatën aktuale të bankës dhe objektivat e saj të huadhënjes. Kompleksiteti dhe programi i politikës dhe procedurës kreditore duhet t'i përshtaten madhësisë dhe natyrës së aktiviteteve të bankës dhe gjithashtu duhet të jenë në përputhje me praktikatat të matura të bankës si dhe kërkesat rregullative nga BPK-ja.

Mbikëqyrësit e BPK-së do të vlerësojnë politikën kreditore të bankës për të përcaktuar kompetencën e saj në raport me madhësinë e bankës dhe aktivitetet e saja të huadhënjes; gjithashtu duhet të vlerësojnë nëse politika është implementuar dhe zbatuar. Mbikëqyrësit do të krahasojnë politikatat dhe proceset që janë përcaktuar apo shkruar dhe që praktikohen nga menaxhmenti dhe stafi.

Elementet e një politike kreditore

Politika kreditore duhet të përcaktoj një mision, udhëzimet për huadhënje dhe udhëzimet për kontroll të brendshëm. Një politikë e përshtatshme e huadhënjes përbëhet nga këto elemente si vijonjë (deri në atë masë sa janë të aplikueshme për operacionet bankare):

- a. **Deklarata e misionit** – Kjo është filozofia e huadhënjes së bankës. Kjo deklaratë duhet të definoj tolerancën e rrezikut bankar , i cila shkallë e rrezikut është e pranueshme për bankën. Toleranca e rrezikut varet nga kapitali i bankës, ambienti ekonomik, përvoja e menaxhimit, dhe aspiratat e rrezikut të aksionarëve. Deklarata përcakton strategjitë me anë të së cilave banka identifikon, matë, kontrollon, monitoron rrezikun dhe i përmbush objektivat e veta. I përcakton standardet për vendimmarrje dhe procedurat e dhënies së kredive.
- b. **Përcaktimi i ekspozimeve kreditore të pranueshme dhe të papranueshme** – Politika e huadhënjes duhet të përcaktoj llojet e kredive që banka do të operoj dhe duhet të përcaktoj direktivat për zbatimin e këtyre llojeve të kredive. Vendimi për lejimin e llojeve të kredive duhet të jenë të bazuara në vlerësimet e ekspertizave të nëpunësve kreditor, në strukturën e depozitave të bankës dhe nevojat paraprake të komunitetit. Kreditë që përmbajnë struktura komplekse apo ato që janë siguruar me kolateral, të cilat kanë nevojë për një vëmendje më të madhe se normale, duhet të mënjahen vetëm nëse/apo deri sa banka të sigurojë personelin e nevojshëm, politikën, kontrollet dhe sistemet e nevojshme për të administruar në mënyrë të duhur kredi të tilla. Llojet e kredive që i kanë sjell një humbje anormale bankës duhet të identifikohen, shqyrtohen, dhe kontrollohen brenda kornizave të politikës së përcaktuar. Një bankë duhet t'i konsiderojë ekspozimet totale të huadhënjes në proporcion me fondet e qëndrueshme.
- c. **Kufizimet në totalin aktiv të ekspozimeve të kredive** - Udhëzuesit që do të kufizojnë limitin e shumës totale të kredive aktive, si dhe marrëdhëniet me bilancet e tjera duhet të themelohen. Kontrollet mbi portofolionë kreditore duhet të shprehen në proporcion me depozitat, kapitalin, dhe totalin e mjeteve. Në përcaktimin e këtyre limiteve, faktor të ndryshëm duhet të merren parasysh, si për shembull: nevojat kreditore të tregut bankar, paqëndrueshmëria e depozitave dhe përfshirja e rrezikut kreditor.
- d. **Kombinimi i portofoliosë së dëshiruar** – Shpërndarja e kredive sipas kategorive duhet të jetë e specifikuar. Kufizimet duhet të jenë të bazuara në përqindje të dëshiruara të kredive të përgjithshme për tregëti, patundshmëri, konsumuese, apo kategori të tjera (si për shembull sektorë gjeografik apo industrial). Këto politika janë fitimprurëse, mirëpo duhet të lejojnë devijime me miratimin e menaxherit të lartë si dhe/ komiteti apo bordi, në mënyrë që të lejojnë që kredia të shpërndahet në proporcion me nevojat ndryshuese të tregut.
- e. **Distribuimi i afatit të shpërndarjes së portofoliosë** – Afatet e kthimit të kredive dhe tejkalimi i afatit për llojet e tjera të kredive duhet të përcaktohen

sipas karakteristikave themelore të bazës së fondeve të bankës, lloji i kredisë dhe qëllimi i kredisë.

- f. **Segmenti i definuar i tregut** – Politika duhet të përcaktoj synimet për ndërtimin e themelit të portofoliosë kreditorë. Këto duhet të jenë konsekuent me ekspertizën e nëpunësve kreditor dhe karakteristikave të tregut.
- g. **Kufizimet tregtare dhe gjeografike** – përfshijnë dhënien e kredive jashtë kufijve të përcaktuar. Banka duhet t'i ketë zonat e saj tregtare të përcaktuara, nëpunësit kreditor dhe bordi duhet të jenë plotësisht në dijeni në lidhje me kufizimet gjeografike për qëllimet e huadhënjes. Zona e tregut të bankës nuk duhet të jetë edhe aq e madhe, sa që të mos jetë në proporcion me burimet, monitorimin e saktë dhe të duhur si dhe administrimin e kredive të cilat duhet të definohen në mënyrë të arsyeshme. Një politikë e tillë shmang aprovimin e kredive të konsumatorëve jashtë zonës tregtare që është në kundërshtim me objektivat primare të bankës. Zona primare tregtare e bankës duhet të dallohet nga çdo zonë sekondare, në mënyrë që të dihet ku të vihet theksimi primar; kjo është shumë e rëndësishme sidomos për bankat e reja. Kufizime specifike ose përjashtimet duhet të jenë të listuara ndaras.
- h. **Kushtet e huadhënjes** – duhet të specifikohen për secilin lloj/kategori të kredisë në portofolio:
- **Çmimi** – Shumë faktorë do të ndikojnë në normën e interesit, duke përfshirë edhe kushtet e tregut dhe konkurruese, qëllimet e biznesit të bankës, si dhe maturimin dhe shkallën e rrezikut të kredive. Normat kamatore për disa lloje të kredive të përcaktuara nga ana e politikës së bankës duhet të jenë të mjaftueshme, para se gjithash për të mbuluar shpenzimet e fondeve, shërbimeve (duke përfshirë ato të përgjithshme) dhe humbjeve të mundshme, gjersa ato të paraqesin një marginë të arsyeshme të profitit. Krijuesit e politikave duhet t'i njohin shpenzimet para se t'i përcaktojnë normat kamatore. Rishikime periodike duhet të bëhen për të rregulluar normat kamatore ndaj ndryshimit të shpenzimeve, faktorët konkurrues, si dhe rreziqet e lidhura me llojet e kredive.
 - **Afati i kthimit** – Kreditë duhet të jepen sipas planeve reale për rikthim. Datat e kthimit duhet të jenë të lidhura me burimet paraprake të kthimit të të hollave, qëllimin e kredisë, dhe shfrytëzimi i kolateralit. Politika duhet të përcaktoj numrin maksimal të muajve në bazë të cilës kreditë mund të amortizohen dhe mundësitë e mbitërheqjeve të likuidohen. Procedura specifike duhet të zhvillohen në lidhje me situatat që kërkojnë pagesa të menjëhershme dhe modifikim të afateve fillestare të kredive. Për të reduktuar rrezikun e financimit, duhet të specifikohen periudhat maksimale të afateve të kthimit dhe kërkesat periodike të pagimit të linjave kreditorë.
 - **Pagesat paraprake/kërkesat kapitale** – Politika e bankës duhet të përcaktoj proporcionin maksimal të shumës së kredisë dhe vlerës së kolateralit. Politika gjithashtu duhet të përmbaj një listë që përmban pagesat paraprake për lloje të ndryshme të pasurisë që kanë nevojë për financim.

- i. **Informatat financiare** – Zgjatja e kredive në baza të sigurta dhe të shëndosha varet nga informatat komplete dhe të sakta për gjendjen financiare të huamarrësit dhe gjendjen e tij kreditore. Përfshirë mund të bëhet për kreditë me kolateral të tregtueshëm, rregullimi i së cilës është bërë fillimisht si burim i kthimit të shumës së lejuar. Informatat aktuale dhe kompletet janë të nevojshme jo vetëm për zanafillën e kredisë, por përgjatë tërë periudhës së lejimit. Politika duhet të përcaktoj shpeshësinë e pranimet të informatave për pasqyrat financiare për llojet e ndryshme të kredive të lejuara nga ana e bankës. Si shtesë, politika duhet të përcaktoj kërkesat e pasqyrave financiare për bizneset dhe individët në shkallë të ndryshme të huadhënjes, të cilat gjithashtu përfshijnë kërkesat për : pasqyra të audituara, vjetore, të përkohshme, bilancet e gjendjes, bilancet e suksesit, rrjedhës së parave të gatshme, ndryshime në kapital, si dhe shënimet tjera mbështetëse, programet dhe analizat e menaxhmentit. Kërkesat për pasqyra financiare duhet të përfshijnë edhe kontrollet e jashtme të kredisë të kërkuara për periudhën e caktuar të azhurinimit. BPK-ja e konsideron këtë element si dokument të detyrueshëm për të gjitha ekspozimet kreditore.
- j. **Përcaktimi i huamarrësve të kualifikuar** – Politika duhet të përcaktoj për secilin huamarrës kriteret minimale personale dhe financiare për çdo lloj të huamarrësve në mënyrë që të përcaktohet karakteri dhe kapaciteti i huamarrësit.
- k. **Kolaterali i pranueshëm dhe margjinat** – Politika duhet të adresoj kualitetin dhe shpeshësinë e vlerësimeve. Politika duhet të përcaktoj ku bie përgjegjësia e vlerësimeve dhe duhet të përcaktoj standardet formale të vlerësimit dhe procedurat e vlerësimit, duke përfshirë pajtueshmërinë me rregullativën, si dhe procedurat për ri-vlerësime ose ri-përcaktime të mundshme në raste të ripërtëritjes apo vazhdimit të kredive. Llojet e pranueshme të vlerësimeve si dhe limitet në shuma dhe lloje të kolateralit të cilat janë të autorizuara për vlerësime nga personeli i bankës po ashtu duhet të caktohen. Duhet të identifikohen gjithashtu rrethanat ku kërkohen vlerësime të stafit të brendshëm për vlerësimin e tarifave.
- l. **Autoritetet e huadhënjes dhe procesi i aprovimit** – Duhet të jetë një proces i aprovimit i dokumentuar për politikën e huadhënjes, duke përfshirë edhe nevojën për aprovim nga menaxhmenti i lartë, bordi, ose komiteti i bordit. Sistemet e raportimit të menaxhmentit duhet të raportojnë dhe të theksojnë përfshirësit e manaxhmentit dhe bordit.

Politika e huadhënjes duhet të përcaktoj kufijtë për të gjithë nëpunësit kreditor. Kufijtë duhet të përcaktohen gjithashtu për autoritetet e grupeve, duke lejuar një kombinim të nëpunësve apo komitetit të aprovoj një shumë më të madhe se sa do të ju lejohej aprovimi individualisht. Politika duhet të përcaktoj situatat kur një aplikim duhet të kalojë në një nivel më të lartë aprovimi. Politika duhet të përfshijë procedura për situatat e ndërlidhura me rritjen e borxhit të një kredimarrësi, interesin e lidhur, apo dokumentet e

dorëheqjes. Procedurat dhe frekuenca e raportimit të mbledhjeve të komitetit duhet të përcaktohen.

- m. **Kufizimet në ekspozimet e mëdha** – Politika e kredisë duhet të mundohet të zhvilloj një shumëllojshmëri brenda portofoliosë që të arrij një bilanc në mes të ardhurave maksimale dhe rrezikut minimal. Ekspozimet e mëdha kreditore shpesh varet shumë nga në një faktor kyçe, dhe kur dobësitë zhvillohen në atë faktor kyçe, çdo kredi individuale brenda kredive të mëdha do të dëmtohet. Politika duhet të definojë ekspozimet e mëdha dhe të themelojë limitet për ekspozimet ndaj një huamarrësi, ose grupit të lidhur të huamarrësve, industri, etj, në aspekt të limiteve ligjore dhe rregullative si dhe të kapacitetit të bankës. Menaxhmenti i lartë dhe/apo bordi duhet të vlerësojnë rrezikun plotësues që është i përfshirë në ekspozimet e mëdha kreditore dhe duhet të përcaktoj cilat ekspozime të mëdha duhet të mënjanojnë ose të kufizohen. Politika duhet të kërkoj gjithashtu që të gjitha ekspozimet e mëdha të rishikohen dhe shpesh të raportohen pranë bordit. Rregulla e II të BPK-së përmban rregulla specifike dhe udhëzues në lidhje me ekspozimet e mëdha. Këto duhet të merren në konsideratë gjatë përpunimit të secilës politikë kreditore

Bankat që kanë në vend kontrole të efektshme për të menaxhuar dhe reduktuar ekspozimet e mëdha kreditore të paligjshme, nuk duhet t'i refuzojnë kreditë e sigurta vetëm për shkak të industrisë së dhe lokacionit gjeografik të huamarrësve.

- n. **Ekspozimet brenda bankës dhe interesat e tyre të lidhura**– T'i huazosh personat e brendshëm të bankës apo interesat e tyre të lidhura, mund t'i sjell rrezik të theksuar bankës. Politika duhet t'i përcaktoj klientët e brendshëm dhe interesat e tyre në bazë të kërkesave dhe definicioneve rregullative dhe ligjore dhe gjithashtu duhet të përfshijë edhe raportimin e këtyre ekspozimeve pranë bordit. Rregullorja e UNMIK-ut 1999/21 dhe Rregulla Bankare e BPK-së Nr XX përmbajnë rregulla specifike në lidhje me ekspozimet e brendshme dhe interesat e tyre të lidhura. Këto duhet të merren në konsideratë gjatë përpunimit të politikës kreditore.
- o. **Procedurat e aplikimit dhe të rishqyrtimit** – Politika duhet të përcaktoj kërkesa për të siguruar informata fillestare nga huamarrësit për lloje dhe nivele të ndryshme të kredive, dhe procesi për verifikimin e një informacioni të tillë duhet të bëhet para lejimit apo dorëzimit së kredisë për aprovim.
- p. **Udhëzues për procedura dhe kontabilitet për kreditë jo performuese, kreditë në proces të mbledhjes, të shlyerjes dhe të mbledhjes** – Politika duhet t'i përcaktoj të gjitha obligimet delikuede/jo performuese dhe të gjitha llojet tjera dhe duhet t'ë diktoj raportet e duhura që ti dërgohen menaxhmentit të lartë dhe/apo bordit. Raportet duhet të përmbajnë detaje të mjaftueshme për t'i mundësuar përcaktimit të saktë të faktorëve të rrezikut, potencialit humbës dhe rrjedhat e mundshme të veprimtimit. Politika duhet të kërkoj një procedurë të përcjelljes së mbledhjes e cila do të ishte sistematike dhe mjaftë progresive. Udhëzimet duhen të themelohen për të siguruar se të gjitha llogaritë i janë prezantuar dhe janë analizuar nga menaxhmenti i lartë

dhe/apo bordi për rezervën për humbje nga huatë dhe fshirjen e kredive në një periudhë të caktuar të delikucencës.

- q. **Direktiva për ristrukturimin e kredisë** – Bankat duhet të kenë standarde të ashpra për të gjykuar nëse një kredi është për t'u ristrukturuar/riprogramuar. Politika duhet t'i radhis faktorët apo kushtet që do të ishin të aplikueshme. Si shtesë, ky element i politikës duhet të jetë në pajtim me kërkesat për kreditë e ristrukturuara që janë themeluar nga BPK-ja. Ju lutemi referojuni Rregullës Bankare të BPK-së Nr. IX.
- r. **Raportet** – Politika duhet t'i përcaktoj llojet e raporteve që do të përpilohen, frekuencën e tyre, si dhe qëllimin dhe përdorimin e këtyre raporteve. Ju lutemi referojuni pjesës pasuese të kësaj Letre Këshilluese në lidhje me llojet e raporteve që BPK-ja i konsideron esenciale për një menaxhim të duhur të rezikut të portofoliosë.
- s. **Organizimi i funksionimit të kredive** – Politika duhet të përfshijë strukturën organizative dhe përgjegjësitë për departamentet e ndryshëm të huadhënjes si dhe themelimin dhe funksionimin e komiteteve të kredive. Ju lutemi referojuni elementeve organizative dhe administrative që janë shënuar në fillim të kësaj Letre Këshilluese.
- t. **Direktiva për blerjen dhe shitjen e bashkëpjesëmarrjeve** – Politika duhet të përcaktoj limitet për grumbullimin e agreguar të kredive për tu blerë dhe shitur ndonjë burimi të jashtëm, si për të gjitha kreditë e blera dhe të shitura. Limitet duhet t'u vihen gjithashtu për grumbullimin e kredive të ndryshme të industrive që mund të blihen. Si shtesë, politika duhet të kërkojë që kreditë që janë blerë nga një burim tjetër të vlerësohen në mënyrë të njëjtë si kreditë që dalin nga vetë banka. Duhet të përcaktohen gjithashtu direktiva për llojet dhe frekuencën e informacionit që duhet të sigurohet nga banka bazë për ta azhurnuar vazhdimisht bankën në lidhje me statusin e kredive. Për shkak të sigurisë së pandarë të bankave bazë për të administruar dhe mbledhur kreditë, banka që blenë duhet të analizojë aftësitë parësore të bankës për të zbatuar këto përgjegjësi. Në anën tjetër, duhet të krijohen direktiva për t'u pajisur me informacione të plota dhe të rregullta në lidhje me kreditë e blera dhe të shitura nga banka.

2. Procesi i huadhënjes

BPK-ja i konsideron procedurat në vijim elemente esenciale për procesin e kredive. Bankat duhet të sigurohen që direktivat e procedurave të tyre kreditore u adresohen këtyre elementeve.

- a. *Aplikimi*. Procesi për një kredi të re apo mundësi tjetër duhet të fillojë duke plotësuar një formë aplikimi nga ana e kandidatit. Kandidati duhet t'i ofroj nëpunësit të bankës informacione të mjaftueshme në mënyrë që të vlerësohet kërkesa e tij. Kandidati duhet të paraqesë pasqyrat financiare, informata në lidhje me kredi të tanishme apo që ka pasur në të kaluarën, dhe nëse kredia do të sigurohet, evidencë për shlyerjen e kolateralit dhe vlera e kolateralit të garantuar që do të sigurohet për

peng. Nëpunësi i bankës duhet të ketë informacionin e duhur për të përcaktuar qëllimin e kredisë, burimin e pagesës, si dhe aftësinë e pagesës së kredisë së kandidatit. Informacioni i njëjtë duhet të mbledhet për të vlerësuar ndonjë kërkesë ekzistuese të huamarrësit për fonde shtesë apo ristrukturim të kredisë.

b. *Shqyrtimi dhe Analizat.* Banka duhet të bëjë një shqyrtim dhe analizë për mundësinë dhe kapacitetin potencial të aplikantit për të paguar kredinë. Nëpunësi i bankës duhet të përmbushë kërkesat e kredisë sipas Regjistrimit të Kredive të Kosovës/byrosë kreditore dhe historisë së mëparshme apo gjendjen momentale të aplikantit në mënyrë që të përcaktojë statusin dhe historinë kreditore të aplikantit. Duhet të shikohet nëse aplikanti ka pasur ose nëse ka kredi për momentin në ndonjë bankë tjetër.

Një nëpunës i bankës me përgjegjësi duhet të shikoj gjendjen financiare të huamarrësit për të përcaktuar kapacitetin e tij për të paguar borxhin nga ndonjë burim i besueshëm i fondeve. Për një individ kjo përcaktohet në bazë të cilësisë dhe shumës të të hyrave; për ndërmarrje në bazë të kapacitetit të përcaktohet nga rrjedha e parave të gatshme dhe vlera neto. Për të pasur një pamje të qartë të kapacitetit të huamarrësit, nëpunësi i bankës duhet të posedoj me gjendje financiare të detajuar. Pa marrë parasysh nëse kredia është apo nuk është e siguruar, oficeri duhet të analizoj gjendjen financiare të aplikantit për të siguruar se kandidati ka mjaft mjete për ta mbuluar borxhin.

Nëse një kredi duhet të sigurohet, nëpunësi i bankës duhet ta vlerësojë kolateralin. Kreditë nuk duhet të krijohen thjeshtë vetëm në bazë të vlerës së kolateralit. Mbulimi i kolateralit duhet të jetë adekuat për ta mbrojtur bankën nga humbja, duke zvogëluar në këtë mënyrë rrezikun kreditor. Direktivat e politikës kreditore, të përshkruara më lartë në këtë letër këshilluese, duhet të dëshmojnë llojet e pranueshme dhe nivelet e kolateralit për secilën kategori të kredisë. Vlerësimi i kolateralit duhet të jetë real nëse është likuiduar nën rrethana të pafavorshme si për shembull në raste të rizotërimit/përvetësimit.

c. *Miratimi dhe mosmiratimi i kredive.* Të gjitha miratimet e nevojshme duhet të jenë në pajtueshmëri me autoritetet e huadhënjes dhe procedurat e aprovimit të theksuara në politikën kreditore. Nëse kredia e aprovuar është përjashtuese për politikën e bankës në njëfarë mënyre, përjashtimi duhet të theksohet, dhe arsyeja për miratimin e saj duhet të theksohet dhe dokumentohet në dokumentacionin e kredimarrësit. Mbikëqyrësit e BPK-së do të shqyrtojnë numrin e përjashtimeve në raport me politikën për të identifikuar nëse politika është në rregull dhe nëse është duke u zbatuar.

d. *Dokumentacioni i kredive.* Të gjitha aplikimet për kredi duhet të dokumentohen me një shkresë premtuese ligjore/marrëveshje të kredisë. Kreditë e mëdha, kreditë komplekse apo mundësitë tjera kreditore shpesh dokumentohen me një marrëveshje kreditore. Shkresa apo marrëveshja e kredisë duhet të ruhet në trezorin e bankës. Një marrëveshje që dokumenton një kredi të madhe duhet të përfshijë informacionin në vijim:

- Qëllimi i kredisë/përdorimi i fondeve

- Shuma e kredisë
 - Burimi dhe koha e pagesës
 - Datat e pagesës dhe afati i kthimit
 - Norma e kamatës
 - Kolaterali, garantuesit
 - Datat në të cilat huamarrësi do t'i ketë fondet në dispozicion
 - Angazhimet në lidhje me mirëmbajtjen e disa aspekteve, si për shembull minimumi i kapitalit, minimumi i raporteteve momentale, minimumi i borxhit në raport me vlerën, etj.
- e. Disbursimi i mjeteve. Mjetet zakonisht transferohen në llogarinë e huamarrësit. Fondet duhet jepen vetëm pasi janë bërë aprovimet e nevojshme, pas kompletimit të marrëveshjes, mbledhjes së dokumentacionit, përpilimi i dokumenteve të kolateralit dhe çdo dokument tjetër ligjor është kompletuar në lidhje me përvetësimin e kolateralit. Pala e siguruar (banka) duhet të kaloj nëpërmjet procesit të “përsoshmërisë” së kërkesës së vet në mënyrë që ta mbroj interesin e vet në kolateralin ndaj kërkesave tjera të kredituesve të huamarrësve. Dokumentacioni i kolateralit duhet të përmbajë evidencën që kërkesa e bankës është përgatitur në bazë të ligjeve dhe zakoneve. Shumat më të larta se 10.000 euro nuk duhet të lejohen të tërhiqen përnjëherë nga huamarrësi. Në vend të kësaj, këto fonde duhet të transferohen me anë të faturave të vlefshme apo dokumente të tjera të duhura.
- f. Krijimi i regjistrit për kredi. Informacioni dhe dokumentacioni në lidhje me ekspozimin kreditor ruhet në dosje të kredisë, për të mundësuar monitorimin e performansës dhe statusit të kredisë si dhe gjendjen e huamarrësit.

3. Dokumentacioni i kredive

Dokumentacioni i kredive është një përmbledhje e dokumenteve që demonstrojnë se huamarrësi ka gatishmëri dhe mundësinë për të paguar kredinë. Këto dokumente duhet të përcaktojnë se banka i përkrah politikën e shëndosha kreditore, ka vepruar me uredi për të ruajtur fondet e bankës dhe të siguroj ripagimin në çdo mënyrë.

Në përgjithësi, këto dokumente duhet të sigurojnë, me sa vijon:

- Identifikimi i huamarrësit, interesat e tij të lidhura, të afërmit, kapitalin, pronarët
- Lokacioni, natyra dhe lloji i biznesit të huamarrësit
- Qëllimi i kredisë
- Burimi primar dhe sekondar i pagesës. (Nëse ka garantues banka duhet të ketë informacion të mjaftueshëm për gjendjen financiare të garantuesit, të hyrat,

likuiditetin, rrjedhën e parave, borxhet e mundshme, dhe faktorë të tjerë relevant (përfshirë këtu klasifikimin e kredisë, nëse është në dispozicion) për të demonstruar kapacitetin financiar të garantuesit për të përmbushur obligimet.)

- Analizimi i kushteve financiare të huamarrësit
- Projektionet e ardhshme të performansës financiare të huamarrësit
- Përvoja e bankës me huamarrësin në obligime tjera kreditore
- Dokumentimi i kolateralit të kredisë; lokacioni i tij, vlera dhe kushtet

Ky dokument duhet të ruhet në dosjen kreditore të kredimarrësit. BPK-ja konsideron se është esenciale krijimi i një sistemi efektiv për të siguruar kompletimin e informatave momentale të kredive dhe dokumentacion si komponentë e nevojshme e huadhënjes së shëndoshë. Mibkëqyrësit e BPK-së do të rishikojnë saktësinë e dokumentacionit kreditor gjatë periudhës së ekzaminimit të brendshëm në bankë.

4. Standardet për shqyrtim të brendshëm dhe sistemet e klasifikimit

Secila bankë duhet ta ketë një proces për të shqyrtuar dhe klasifikuar rrezikun e ekspozimeve kreditore. Procesi i shqyrtimit duhet të jetë i përcaktuar me anë të politikave dhe procedurave të shkruara dhe duhet të kryhet nga individë që janë të pavarur në obligimet e tyre të përditshme në fushat e shqyrtuara. BPK-ja nëpërmjet programit të saj për ekzaminime të brendshme, do të shqyrtoj adekuatshmërinë e sistemit të shqyrtimit të bankës dhe proceset e klasifikimit. Mbikëqyrësit e BPK-së do të përdorin karakteristikat/standardet në vijim për të vlerësuar kompetencat dhe efektivitetin:

- Ekzistimin e politikës e cila shpreh qartë përgjegjësitë e funksionimit të shqyrtimit.
- Nëse politika i definon klasifikimet e bankës/sistemet për klasifikimin e rrezikut
- Nëse definicionet për klasifikimin e rrezikut janë të qarta dhe të kuptueshme për të gjithë stafin
- Nëse sistemi për klasifikimin e rrezikut është konsistent me kërkesat klasifikuese të BPK-së
- Aftësia e funksionimit të shqyrtimit për të komunikuar drejtpërdrejt menaxhmentit të lartë dhe bordit.
- Nëse personeli i kualifikuar me aftësi të analizimit të kredive dhe njohjen e operimeve të huadhënjes së bankës e ka bërë shqyrtimin.
- Shkalla e mbështetjes dhe përgjegjësisë nga ana e bordit dhe menaxhmentit ekzekutiv

Në veçanti, funksionimi i shqyrtimit të rrezikut kreditor duhet të përmbush me sa vijon:

- Raporte kohore në lidhje me rrezikun e portofoliosë kreditore për menaxhmentin dhe bordin, duke përfshirë këtu edhe vlerësimet e kontrollave të brendshme, vlerësime objektive të kualitetit të mjeteve të portofoliosë dhe vlerësimin e ndikimit potencial të ekspozimeve problematike.
- Tëshqyrtojë ekspozimet materiale vazhdimisht apo në mënyrë periodike në baza të rregullta dhe të papërcaktuara (jo më pak se në çdo tre muaj)
- Të shqyrtojë kontrollat e brendshme sa i përket huadhënjes, investimeve ose funksioneve tjera të bankës që janë shqyrtuar.
- Të sigurohet se problemet dhe problemet potenciale të kredidhënies identifikohen me kohë dhe sa më herët që është e mundur.
- Klasifikoj ekspozimet kreditore problematike në moment që rreziku i tyre evidentohet.
- Të sigurohet se kreditë problematike janë nën vështrime shtesë apo korigjuese
- Të sigurohet se ndonjë ga dobësitë e dokumentacionit janë identifikuar dhe plotësuar.
- T'i përcaktoj adekuatshmërinë e provizionit dhe të rekomandojë shuma shtesë të provizionit.
- T'i citoj shkeljet dhe mospajtimet me ligjet në fuqi, Rregullat e BPK-së dhe politikën e brendshme të bankës.
- Të krijoj raporte për korigjimet e bëra në lidhje me ekspozimet problematike dhe rekomandimet pasuese.
- Të ndihmoj në zhvillimin dhe plotësimin e politikave përkatëse në lidhje me ekspozimet e rrezikut kreditor
- Të vlerësojë trendet e kredive, investimeve dhe/apo portofoliosë së bankave korrespondente

Udhëzuesit e BPK-së për shqyrtimin e kredive theksojnë se portofolio kreditore, angazhimet jashtë bilancore dhe detyrimet e rastit (si p.sh. pjesë të papërdorura të fondeve të ligjshme të kredive, letrave të kredisë, garancionet), duhet të shqyrtohen në baza të vazhdueshme :

- Së paku tre here në muaj për ekspozimet kreditore për një individ apo grup të caktuar huamarrësish, shuma totale e të cilëve tejkalon 0.5% të kapitalit të bankës dhe rezervave;

- Së paku çdo gjashtë muaj për ekspozimet kreditore për një individ apo grup të caktuar huamarrësish, shuma totale e të cilëve është barazi ose më pak se 0.5% të kapitalit të bankës dhe rezervave;
- Grupet e kredive të vogla me karakteristika të njëjta, si për shembull portofolio konsumuese, që është aprovuar sipas një metodologjie të caktuar dhe kanë kërkesa standarde të amortizimit, mund të shqyrtohen në bazë të karakteristikave të mbledhura, si p.sh. ditët delikvente dhe të klasifikuara/përcaktuara në përputhje me provizionimin. Shiko Rregullën Bankare të BPK-së Nr. IX.